

Njoftim për përqendrim me të cilin “Blicnet” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për telekomunikacione Banja Lluka, Bosnje dhe Hercegovina do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi kapitalin themelor të “KG 1” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Gorazhde, Bosnje dhe Hercegovina

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 25.11.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftimi për përqendrim, me cilin “Blicnet” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për telekomunikacione Banja Lluka, me seli të regjistruar në rrugën Vuka Karaxhiqa numër 2, Banja Lluka, Bosnje dhe Hercegovina, do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi kapitalin themelor të “KG 1” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Gorazhde, Federata e Bosnje dhe Hercegovinës, me seli të regjistruar në rrugën Lagjja Panorama pn Gorazhde, Federata e Bosnje dhe Hercegovinës, Bosnje dhe Hercegovinë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste

“Blicnet” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për telekomunikacione Banja Lluka është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikacione kabllore, ndërsa nga shërbimet që ofron, veçojmë shërbimet për telefoni fikse dhe celulare, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës.

“Blicnet” është në pronësi të Telekomunikacioneve të Republikës Srpska shoqëri aksionare, Banja Lluka, Bosnje dhe Hercegovina (“MTEL BL”), ndërsa MTEL BL është në pronësi shumice të Telekom Serbia, shoqëri aksionare Beograd, Serbi (“Telekom Serbia”).

Person i lidhur i Telekom Serbia në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e të cilës është e regjistruar në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë telekomunikacione me tela (kabllore), përkatësisht për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: rrjet publik i radio-komunikimit, qasje broadband (me brez të gjerë) në internet, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike të qasshme publikisht në rrjet publik të komunikimit celular, ritransmetim i shërbimeve programore televizive, satelit.

Person i lidhur i MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikacione MTELMOBILE SHPKNJP Shkup. Shoqëria për telekomunikacione MTELMOBILE SHPKNJP Shkup punon në tregun për ofrimin e shërbimeve celulare të komunikimit elektronik (shërbimi me parapagesë/prepaid) dhe nuk u ofron shfrytëzuesve të saj përfundimtarë shërbim celular postpaid. Shoqëria për telekomunikacione MTELMOBILE SHPKNJP Shkup është operator virtual i rrjetit celular (OVRRC) në tregun maqedonas për komunikime elektronike dhe ofron shërbime zanore kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming, SMS dhe internet.

Gjithashtu, person i lidhur i Parashtruesit të njoftimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup (“TOTAL TV SHPK Shkup”), me seli në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë telekomunikacione satelitore.

“KG 1” shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Gorazhde është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, në momentin e parashtrimit të Njoftimit, i regjistruar për ofrimin e

qasjes në internet dhe shërbime interneti, shpërndarje të përmbajtjes mediatike në territorin e Bosnje dhe Hercegovinës.

Shoqëria e synuar nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Për qëllimet e vlerësimit të këtij përqendrimi, parashtruesi i njoftimit propozon që si treg përkatës të përkufizohet tregu për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse broadband në internet, tregu i shitjes me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të mbërrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi.

27.11.2025

Shkup